

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-103/14

Prishtinë, 27 janar 2016

Në çështjen juridike të:

A.I.

Rruga Petra Bojovića I
18430 Kuršumlija
Republika e Serbisë
Tel. 063-7350019

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA06758) të datës 21 Gusht 2013, pas seancës të mbajtur më 27 janar 2016 mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e A.I. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 i datës 21 Gusht 2013 për sa i takon lëndës të regjistruar me numrin KPA06758.**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/212/2013 i datës 21 Gusht 2013 për sa i takon lëndës të regjistruar me numrin KPA06758.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datën 5 mars 2007, A.I. (Abkuesi) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës duke pretenduar se ai është bartësi i së drejtës pronësore dhe ku kërkon ri-posedim të pronës së paluajtshme e cila ndodhet në Podujevë, në vndin e quajtur Livadičko Polje (Livadicë), ngastrat kadastrale nr.238/2 dhe 239/2 me sipërfaqe prej 00.66.32 ha me kulturë arë dhe livadh në Zonën kadastrale Livadisë(në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ai thekson se e ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të rrethanave që ndërlikohen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/99 që ka ndodhur në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, Ankuesi ka dorëzuar në Agjencinë Kosovare të Pronave(në tekstin e mëtejme: AKP) dokumentet vijuese:
 - Letërnjoftim datë 03 Shtator 1992 lëshuar nga autoriteti i punëve të brendshme ne Podujevë.
 - Dy versione të Litës Poseduese Nr.31, një të datës 2 nëntor 2006 dhe tjetra e datës 20 shkurt 2008, lëshuar nga Kadastru i Komunës së Podujevës i dislokuar në Serbi që tregon se paraqitësi i kërkesës evidentohet si pronar i pronës së kërkuar.
 - Kopje e planit lëshuar nga Zyra Kadastrale e Podujevës datë 20 Nëntor 1995 .
 - Aktgjykim mbi bazën e pohimit nga Gjykata Komunale e Kuršumlisë P.br.21/94 i datës 13 Qershor 1994 që tregon se Kontrata e lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore “Sloga” në Podujevë si blerëse dhe Ankuesit si shitës, e lidhur me 28 Dhjetor 1970 me objekt midis tjerash edhe pronën e kërkuar. Kontrata shpallet pa vlerë juridike dhe obligohet Kooperativa Bujqësore “Sloga” në Podujevë që ti njohë Ankuesit pronësinë mbi pronën e kërkuar.
3. AKP-ja *ex-officio* kishte gjetur se në të dhënat kadastrale të Drejtorinë për Kadaster, Gjeodezi dhe pronësi të Komunës së Podujevës Fistën Poseduese nr. 47, datë 25 tetor 2007. Sipas fletës poseduese ngastrat nr. 238 dhe 239/2 në Livadicë evidentoheshin si ngastra në pronësi

shoqërore që i përkisnin Kooperativës Bujqësore në Podujevë. Në të dhënat kadastrale thuhet se pjesa e ngastrës 239/2 i është ndarë nga Komuna e Podujevës Klubit Futbollistik “Besiana”, kurse ngastra 238 është gjetur e pandarë dhe figuron si pronë shoqërore.

4. Dokumentet e paraqitura nga Ankuesi, siç janë fleta poseduese e lëshuar nga kadastra e dislokuar dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komuale në Kuršumli janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
5. Më 14 Shtator 2007, AKP-ja ka kryer identifikimin e pronës së kërkuar dhe prona ishte gjetur si tokë e kultivuar por nuk ishte paraqitur askush, dhe AKP-ja ka njoftuar kërkesën duke vendosur publikimin në pronën e kërkuar, por askush nuk ishte përgjigjur në kërkesë. AKP-ja ka konfirmuar njoftimin me 12 maj 2010, dhe është theksuar se pronë ishte identifikuar saktësisht. Më 1 Korrik 2010, kërkesa ishte publikuar në Gazetën e Agjencisë, zyrën e UNHCR-së dhe ishte dorëzuar kryeplakut të fshatit Xh.S.. Përveç kësaj njoftimi ishte dërguar edhe në Komunën e Podujevës, Gjykatën Komunale në Podujevë dhe Zyrën Rajonale të Agjencisë në Prishtinë.
6. Me vendimin e KKPK-ës nr. KPCC/D/C/212/2013 të datës 21 Gusht 2013, kërkesa e palës ankuese ishte hedhur. KKPK-ja arsyeton se asnjë provë nuk dëshmon se Ankuesi kishte rimarre në posedim pronën e kërkuar pas anulimit të kontratës së lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore dhe Ankuesit. Edhe pse Ankuesit i është kërkuar që të paraqiste më shumë të dhëna gjithashtu, përveç që në të dhënat kadastrale të zhvendosura në të cilat thuhet se prona e kërkuar është regjistruar në emër të Ankuesit. Sekretariati i kërkoi palës dëshmitë për hapat e mëtejme të zbatimit të aktgjykimit por pala nuk siguroi prova. Meqenëse nuk u ofrua asnjë dëshmi nga Ankuesi se prona ishte rimarrë në posedim, KKPK-ja arriti në perfundimin se Ankuesi nuk e ka humbur posedimin si pasojë e konfliktit (KPCC/D/C/212/2013 të datës 21 Gusht 2013 paragrafët 26-28)
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar Ankuesit me 8 Prill 2014. Ai ka paraqitur ankesë më 8 Maj 2014. Me 16 maj 2014 ai i kishte bashkangjitur ankesës së tij të njëjtat dokumente që i kishte dërguar në AKP për të mbështetur kërkesën e tij.

8. Asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-ës e as para Gjykatës Supreme.

Pretendimet e Palës ankuese

9. Pala ankuese ka kërkuar që vendimi i KKPK-ës të anulohet duke theksuar se ai ka paraqitur para KKPK-ës prova të mjaftueshme se ai është pronar i pronës së kërkuar. Prandaj, ai kërkon nga Gjykata Supreme të aprovoj ankesën e tij dhe të ndryshojë vendimin e KKPK-së në dobi të tij, dhe t'ia kthejë posedimin mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur mbrenda afatit kohor prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullorës së UNMIK-ut mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e plauajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e plotësuar me Ligjin no. 03/L-079.
11. Sipas nenit 3.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja ka kompetenca për t'i zgjidhur kërkesat në lidhje me të drejtat pronësore “të cilat janë të lidhura ose që rrjedhin nga Konflikti i ndodhur në Kosovë midis 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999”. Prandaj, Ankuesi jo vetëm që duhet të ofroj-provoj pronësinë mbi pronën private të paluajtshme, por duhet gjithashtu që të provoj se ajo është në pamundësi të ushtrimit të këtyre të drejtave për shkak të rrethanave të lidhur drejtëpësdrejtë ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur.
12. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë dhe mbi bazën e këtyre fakteve gjeti se:
13. Ankesa është e pa bazuar.

14. Në rastin konkret Ankuesi nuk ka dëshmuar para KKPK-ës se është ekzekutuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Korshumlisë dhe se humbja e posedimit ka ndodhur për shkak të rrethanave që drejtpërdrejte ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur. Në ankesë ai nuk ka ofruar kurfarë informacioni i cili do të dërgonte në një vendim tjetër.
15. Ankuesi, duke mos zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës me të cilin i njëjët e drejta pronësore mbi pronën e kërkuar ka dështuar që të dëshmoi se e ka kthyer posedimin mbi pronën e kërkuar para konfliktit dhe që e ka humbur atë më vonë si pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998/99 që ka ndodhur në Kosovë.
- 14 Përfundimisht, Gjykata gjeti se vendimi i KKPK-ës është i drejtë dhe se meritat e kërkesës fillimisht dhe të ankesës nuk mund të shqyrtohen në këtë procedurë për shkak se ato bien jashtë jurisdikcionit të KKPK-ës.
- 15 Ky aktgjykim nuk përjashton faktin që Ankuesi mund t'i kërkojë të drejtat e tij të pretenduara në pronën e kërkuar pranë gjykatës kompetente.
- 16 .Nga sa u tha më lartë, sipas nenit 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në aktgjykimin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it